



**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION**

Bazuar në nenin 10 par.1 pika 10 të Ligjit për Avokatinë lidhur me nenin 83 par.2 të Statutit të OAK, Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve të Kosovës në seancën e mbajtur më 28 dhjetor 2013, nxjerr këtë:

**RREGULLORE PËR PROVIMIN NGA KODI I ETIKËS PROFESIONALE
TË AVOKATËVE**

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet për administrim të provimit nga Kodi i Etikës Profesionale të Avokatëve (më tutje: Provimi), kriteret për zgjedhjen dhe mandatin e anëtarëve të komisionit për provim (më tutje: Komisioni), kompetencat e komisionit, mënyra e punës dhe vlerësimit dhe çështje tjera të rëndësishme për organizimin dhe mbajtjen e provimit.

Neni 2

Kushtet për hyrje në provim

Të drejtë për hyrje në provim kanë kandidatët që kanë përfunduar Fakultetin Juridik dhe provimin e jurisprudencës.

Neni 3

Komisioni

1. Provimi jepet para Komisionit të formuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës.
2. Komisioni përbehet nga 3 anëtarë si dhe zëvendësit e tyre.
3. Anëtarët e Komisionit dhe zëvendësit e tyre zgjedhën nga Këshilli Drejtues me mandat 2 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat.

Neni 4

Kriteret për përzgjedhje të Komisionit

Për anëtarë të komisionit si dhe zëvendës të tyre mund të zgjedhën avokati;

- 1) I cili ka 10 vite përvojë pune si avokat.
- 2) I cili ka kaluar së paku një mandat në organet apo komitetet e OAK.
- 3) Ndaj të cilit në 10 vitet e kaluara nuk është shqiptuar ndonjë masë e plotfuqishme disiplinore.

Neni 5

Paraqitja e provimit

1. Paraqitja e provimit bëhet deri 7 ditë para mbajtjes së Provimit.
2. Për paraqitjen e provimit, kandidati duhet të paraqes këto dokumente:
 - i. Fotokopjen e vërtetuar të diplomës së Fakultetit Juridik

- ii. Fotokopjen e vërtetuar të certifikatës provimit të jurisprudencës
 - iii. Kopjen e letërnjoftimit
 - iv. Fletëpagesën për provim
3. Lartësinë e pagesës për provim e cakton Këshilli Drejtues i OAK.

Neni 6

Organizimi dhe mbajtja e provimit

Provimi organizohet 6 herë në vit përkatësisht çdo dy muaj në zyrat e OAK.

Neni 7

Mënyra e dhënies së Provimit

1. Para fillimit të provimit stafi administrativ i OAK verifikon identitetin e kandidatëve nëse kandidatët kanë plotësuar kushtet për hyrje në provim sipas kësaj Rregullore.
2. Provimi mbahet me shkrim në prezence të së paku një anëtari të komisionit.
3. Gjatë provimit kandidati nuk ka të drejtë të shfrytëzoj asnjë lloj literature e as pajisje elektronike apo telefon e as të komunikoj me kandidatet tjerë.

Neni 8

Rezultati i provimit

1. Provimi është dhënë nëse ka vlerësim pozitiv në më shumë 75 % e pyetjeve të provimit.
2. Me rezultatet e provimit kandidatët njoftohen brenda 7 ditëve të punës nga dita e mbajtjes së provimit.

Neni 9

Përsëritja e provimi

Përsëritja e provim mund të bëhet në afatin e ardhshëm të provimit.

Neni 10

Shtyrja e afatit të provimit

1. Kandidati që është paraqitur për provim në afatin e caktuar mund të shtyj provimin për shkaqe të arsyeshme duke informuar me shkrim Komisionin.
2. Provimi mund të shtyhet jo më shumë se për afatin tjetër të radhës.
3. Nëse kandidati nuk i nënshtrohet provimit në afatin e parë të radhës do të konsiderohet se i njëjti ka hequr dorë nga provimi.

Neni 11

Procesverbali i vlerësimit të Provimit

1. Komisioni përpilon procesverbal për vlerësimin e kandidatëve që i nënshtrohen provimit.
2. Në procesverbal shënohen emri dhe mbiemri i kandidatit dhe rezultati i provimit.
3. Komisioni i dërgon procesverbalin e provimit Drejtorit Ekzekutiv të OAK.

Neni 12

Certifikata për dhënien e provimit

1. Në bazë të procesverbalit të Komisionit për provim kandidatëve ju lëshohet certifikata për dhënie të provimit i cili nënshkruhet nga Kryetari i OAK dhe Kryetari i Komisionit.
2. Në certifikatë shënohen emri, emri i prindit dhe mbiemri, data dhe vendi i lindjes i kandidatit, data dhe vendi i lëshimit të certifikatës si dhe nënshkrimi i Kryetarit të OAK dhe Kryetarit të komisionit. Procesverbali i dhënies së provimit ruhet në OAK
3. Dizajni i certifikatës aprovohet nga Këshilli Drejtues.

Neni 13

Evidentimi i dhënies së provimit

Evidentimi i dhënies së provimit bëhet në libra të posaçëm të OAK.

Neni 14

Programi i provimit

1. Programi i provimit përgatitet nga Komisioni
2. Programi i Provimit aprovohet nga Këshilli Drejtues

Neni 15

Hyrja ne fuqi

Rregullorja hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve të Kosovës dhe zbatohet nga data 01 Janar 2014.

Av. Ibrahim Z. Dobruna,
Kryetar i OAK-së